

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.92/2019	Data:30.07.2019	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), në bazë të nenit 10, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe pas marrjes të Pëlqimit nga MMPH-ja për miratim të Planit Zhvillimor Komunal të Istogut 2019-2026, të iniciuar dhe hartuar nga Komuna e Istogut në konsulencë me kompaninë "Urban PLUS" nga Prishtina, në mbledhjen e mbajtur më 30.07.2019 mori këtë:

V E N D I M PËR PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL 2019-2027

1. MIRATOHET Plani Zhvillimor Komunal i Istogut 2019-2027.
2. Për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal të Istogut 2019-2027 është përgjegjës: Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mjedis.
3. Hartimin e "Planit Zhvillimor Komunal të Istogut 2019-2026 "e ka bërë Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis në konsulencë kompaninë "Urban PLUS" sipas procedurave të parapara ligjore.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e zyrtare të Komunës.

Më kopje të këtij vendimi të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.


 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 Nr: 01-039-51 Data 06.08.2019
 Br: Datum
 ISTOG-ISTOK


 Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Qaush BALAJ

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY	 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.93/2019	Data:30.07.2019

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40.2 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen e lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më:30.07.2019 shqyrtoi Transferin e mjeteve buxhetore të komunës për vitit 2018 të parashtruar nga Kryetari dhe mori:

V E N D I M

Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale (fondi burimor 10)

1. Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia - (180) nën-programi Infrastruktura rrugore (18017) kodi funksional (0451), nga projekti: me kod 47796 "Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike ", shuma prej 9,700.00 €,

Në projektet:

me kod (47785) "Kubezimi i trotuareve Bellopojë Veriq", shuma prej 3,800.00 €.

me kod (49043) "Kubëzimi i trotuareve "Istog -Dushkajë-Dubravë"-vazhdim, shuma prej 2,500.00 €.

me kod (49044) "Kubëzimi i trotuareve Vrellë-Stupe-Kamenicë", shuma prej 500.00 €.

me kod 49046 "Ndertimi i shtëpive për të pa strehë", shuma prej 2,900.00 €.

Në kuadër të programit Zyra Komunale per komunitete dhe kthim (19585) kodi funksional (1090), nga projekti me kod (48852) " Kanalizimi në Llukac i Begut" shuma prej 13,503.00 €

Në projektin me kod (48860) "Ndërtimi i rrugës Shalinovicë - Zallq" , shuma prej 13,503.60 €.

2. Në kuadër të programit Zhvillimi Ekonomik - (480) nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi ekonomik (48017) kodi funksional (0411), Nga: projekti me kod (46375) "Ndërtimi i rrugëve në Cerrcë lagja Haskaj" , shuma prej 12,000.00 €,

në projektin

me kod (46318) "Ndërtimi i rrugëve në Kashicë", shuma prej 12,000.00 €,

dhe nga projekti:

me kod (48879), "Ndërtimi i rrugëve në Banjë", shuma prej 3,000.00 €,

në projektin:

me kod (46318), "Ndërtimi i rrugëve në Kashicë", shuma prej 3,000.00 €.

Transfer i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale (fondi burimor 10)

3. Programi Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia - (180) nën-programi Infrastruktura rrugore (18017) kodi funksional (0451), nga projekti: me kod (47796) "Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike", shuma prej 300.00 €,

Në programin Zhvillimi Ekonomik - (480) nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi ekonomik (48017) kodi funksional (0411), në projektin Me kod (48886) "Ndërtimi i rrugëve „Hul Huli” në Istog”, shuma prej 300,00 €.

4. Programi Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia - (180) nën-programi Infrastruktura rrugore (18017) kodi funksional (0451) nga projekti: me kod (47801) "Ndërtimi i deponisë në Tuçep", shuma prej 5.200.00 €,

Në programin Zhvillimi Ekonomik - (480) nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi ekonomik (48017) kodi funksional (0411), në projektet: Me kod (48886) "Ndërtimi i rrugëve „Hul Huli” në Istog”, shuma prej 2.550,00 €,

Projekt i ri "Ndërtimi i kanaleve përgjatë asfaltit në rrugën "Halil Baku" në Kaliqan" shuma prej 2.650,00 €.

Transfer i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike shpenzime kapitale (fondi burimor 21)

5. Programi Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile dhe Emergjencia - (180) nën-programi Infrastruktura rrugore (18017) kodi funksional (0451) nga projekti: me kod (47796) "Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike", shuma prej 1,050.00 €,

Në programin Zhvillimi Ekonomik - (480) nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi ekonomik (48017) kodi funksional (0411) në projektin:

Me kod (48886) "Ndërtimi i rrugëve „Hul Huli” në Istog”, shuma prej 1.050,00 €.

6. Obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa që më planin e Rishikimit të buxhetit komunal të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për procedim të mëtejshëm në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.

7. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e zyrtare të Komunës.

Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.96/2019	Data:30.07.2019	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe në bazë të nenit 33 paragrafi 3 i paragrafit 3.1 i të Statutit të Komunës së Istogut Nr. 62/2010 i miratuar me 30.11.2010, në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJËN E MJETEVE FINANCIARE PËR NDERMARRJËN PUBLIKE "STACIONI I AUTOBUSVE" SH.A. NË ISTOG

1. **MIRATOHET:** Propozim - Vendimi i kryetarit të komunës për ndarjen e mjeteve financiare për përkrahje të Ndërmarrjen Publike "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Istog, dhe shuma prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria ekonomike e projekteve kapitale. Shuma e mjeteve financiare prej 25.000,00€ (njëzetë e pesë mijë euro) ndahen nga kodi ekonomik 49025 i projektit kapital "Fasadimi i ndërtesave të banimit në bashkëpronësi të paraluftës", si dhe 5.000,00€ (pesë mijë euro) transferohen për përkrahje nga kodi ekonomik 47786 i projektit kapital "Kubzimi i trotuarit Istog-Cërrcë" faza e tretë.

Këto mjete financiare transferohen për përkrahje financiare të Ndërmarrjen Publike "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Istog.

2. Mjetet e cekura në piken 1 të këtij Vendimi për kompanin Ndërmarrjen Publike "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Istog, do të shfrytëzohen për shlyerjen (paguarjen) e obligimeve të kësaj Ndërmarrje, ndaj personave Juridik, stafit dhe për shpenzime tjera të Ndërmarrjes.

3. Obligohet stafi kompetent i Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve" SH.A. në Istog, që të njoftoj kryetarin e komunës me ecurinë e shpenzimeve të mjeteve të cekura në këtë vendim.

4. Për zbatimin e këtij Vendim do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e zyrtare të Komunës.

Më kopje të këtij vendimi të njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E ISTOGUT
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE
Uales-Izlazna

Kryesuesi i Kuvendit,
Z. Gaoth BALAJ

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.97 /2019	Data: 30.07.2019	

Në bazë të nenit 12.2 pika d), nenit 73, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe në zbatim të nenit 28, 29, 30 dhe neni 42 paragrafi 42.2 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.55/14, si dhe bazuar në Udhëzimin administrative nr.01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës së Istogut, në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2019 miraton këtë:

VENDIM MBI THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR ARSIM

1. Miratohet vendimi për themelimin e komitetit konsultativ për Arsim, në përbërje prej 5 (pesë) anëtareve, si vijon me poshtë:
 - 1) Rina Buleshkaj, prof. Gjuhës Angleze,
 - 2) Valdrin Kamberaj, fakulteti Juridik,
 - 3) Vintor Zeqiraj, TIK,
 - 4) Shaban Shatri, prof. Gjuhës Angleze,
 - 5) Januz Ahmetaj, Ing. Makineris.
2. Të drejtat dhe përgjegjësit e komitetit konsultativ janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në Komunë.
3. Mandati i anëtarit të komitetit konsultativ nga pika 1 e këtij vendimi është 4 (katër) vjeçar, nga themelimi i komitetit.
4. Anëtarët e një komiteti konsultativ nuk mund të shërbej me shumë se sa dy mandate radhazi.
5. Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i komitetit konsultativ zgjidhet me shumicën e votave të anëtareve të komiteti.
6. Anëtarët e Komiteteve konsultative kompensohen nga buxheti i komunës, dhe shuma e kompensimit apo mëditja është në lartësi prej 50 € (pesëdhjetë euro), ku nuk mund të paguhet më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
8. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministra e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
 OPŠTINA ISTOG
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna



Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Qaush Balaj

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.98 /2019	Data: 30.07.2019	

Në bazë të nenit 12.2 pika d), nenit 73, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe në zbatim të nenit 28, 29, 30 dhe neni 42 paragrafi 42.2 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.55/14, si dhe bazuar në Udhëzimin administrative nr.01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës së Istogut, në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2019 miraton këtë:

VENDIM

MBI THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR SHËRBIME PUBLIKE

1. Miratohet vendimi për themelimin e komitetit konsultativ për Shërbime Publike, në përbërje prej 5 (pesë) anëtareve, si vijon me poshtë:
 - 1) Shqipdona Kajtazi, fakulteti i Biznesit,
 - 2) Shyhrete Ukaj, fakulteti i Biznesit,
 - 3) Šeki Kandić, MTHO,
 - 4) Nezir Jahaj, fakulteti Juridik,
 - 5) Diana Alushaj-Veselaj, fakulteti Administratë Publike.
2. Të drejtat dhe përgjegjësit e komitetit konsultativ janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në Komunë.
3. Mandati i anëtarit të komitetit konsultativ nga pika 1 e këtij vendimi është 4 (katër) vjeçar, nga themelimi i komitetit.
4. Anëtarët e një komiteti konsultativ nuk mund të shërbej me shumë se sa dy mandate radhazi.
5. Kryesuesi dhe zëvendës kryesuesi i komitetit konsultativ zgjidhet me shumicën e votave të anëtareve të komiteti.
6. Anëtarët e Komiteteve konsultative kompensohen nga buxheti i komunës, dhe shuma e kompensimit apo mëditja është në lartësi prej 50 € (pesëdhjetë euro), ku nuk mund të paguhet më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
8. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministri e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.99/2019	Data:30.07.2019	

Në bazë të nenit 12.2 pika d), nenit 73, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe në zbatim të nenit 28, 29, 30 dhe neni 42 paragrafi 42.2 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.55/14, si dhe bazuar në Udhëzimin administrative nr.01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës së Istogut, në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2019 miraton këtë:

V E N D I M PËR ANULIM TË KONKURSIT PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KONSULTATIV PËR SHËNDETËSI

1. Anullohet konkursi për Komitetin Konsultativ për Shëndetësi, për shkak së në intervistën e thirrur nga paneli përzgjedhëse i këtij komiteti, nga 10 dhjetë kandidatë që janë ftuar në intervistim, kanë marr pjesë vetëm katër 4 kandidatë, gjë që e ka pamundësuar themelimin e këtij Komiteti.
2. Kuvendi Komunal në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2019 vendosi që konkursi të anulohet, dhe të rishpallet përsëri, me të njëjtin panel përzgjedhëse, sipas procedurave në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.1/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteteve konsultative në komuna.
3. Obligohet Kuvendi i Komunës që të vazhdojë proceduarat tjera sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 1/2016.
4. Ky Vendim hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e zyrtare të Komunës

Më kopje të këtij vendimi të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 Nr: 01-039-58 Data: 06-08.2019
 Br: Datum


 Kryesuesi i Kuvendit,
 z. Qaush Balaj

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr.100 /2019	Data: 30.07.2019	

Kuvendi i Komunës së Istogut, në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28/2008) në mbledhjen e mbajtur më: 30.07.2019, mori këtë:

V E N D I M

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMBUSHJEN E TRANSPARENCËS NË KOMUNË 2019-2023

1. Miratohet Plani i veprimit për përmbushjen e transparencës në komunën e Istogut 2019-2023,
2. Ky Planë është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.
4. Me kopje të këtij Vendimi të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.



Kryesuesi i Kuvendit,
z. Qasim Balaj



 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE
 Uales-Izlazna
 Nr: 01-039-58
 Br: 06.08.2019
 Datum
 ISTOG-ISTOK

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.91 /2019	Data: 30.07.2019	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, dhe nenit 45.4 të ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësiive publike, Nr.03/L-048, në mbledhjen e mbajtur me 30.07.2019. Shqyrtoj Raportin Financiar për tre mujin e dytë Prill – Qershor të vitit fiskal 2019, për:

NJOFTIMIN ME RAPORTIN FINANCIAR PËR TRE MUJIN E DYTË PRILL -QERSHORE TË VITIT FISKAL 2019

1. Kuvendi i Komunës shqyrtojë dhe debatoj Raportin Financiar për tre mujin e dytë Prill – Qershor të vitit fiskal 2019.
2. Raporti Financiar i paraqitur në formë tabelore është pjesë përbërëse e këtij njoftimi.
3. Me kopje të këtij Njoftimi të njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Financave, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendi.

